



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 446/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkitazi me ankesën e subjektit politik Levizja Vetevendosje (LVV) e cila i drejtohet Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 13.12.2010, mori:

### VENDIM

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Levizjes Vetevendosja (LVV)

### ARSYETIMI

Më datë 12.12.2010 PZAP-i ka pranuar ankesë nga subjekti politik LVV, e cila i drejtohet KQZ, pasi me date 12.12.2010 në shkollën fillore Dardania në Prishtinë, Qendra e Votimit 1904 E, Vendvotimi (VV) 12 në disa klase janë vendosur nga 4 vëzhgues të PDK-se. Parashtruesi i ankesës argumenton se të njëjtët vëzhgues janë rikthyer në vendvotim edhe pse ju është tërhequr vërejtja nga vëzhguesit e LVV-se. Përmes kësaj ankese parashtruesi pretendon se është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009 pika 3.2- pasi jo me shume se dy vëzhgues nga organizata e njejte e akredituar mund të jete prezent në të njëjtën qendër VV.

Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë materiale, përveç se ka siguruar një numër telefoni i cili i perket Rina Dragidella dëshmitare në vendngjarje.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si më poshtë:

*59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e palejuar**

PZAP-i vlerëson se ankesa e LVV-se paraqitur kundrejt KQZ-se është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe rregullimin e numrit të vëzhguesve brenda VV-ve, fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 446/2010 më datën 13.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit**

**Muharrem Shala**

